

VENDIM
Nr.540, datë 21.12.1992

PËR KRIJIMIN E KËSHILLAVE TË KULTURËS DHE SHPËRBLIMIN E TYRE

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, këshillave të rretheve e bashkive të krijohen këshillat e përhershëm të kulturës, të përbërë nga njerëz të shquar në fushën e artit e të kulturës. Këshilli i kulturës miratohet nga ministri për ministrinë, kryetari i rrethit për rrethin, kryetari I bashkisë për bashkinë dhe për institucionet qendrore propozohet nga kolektivi dhe miratohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Këshilli vepron pranë këtyre organizmave si organ këshillimor për drejtimin e politikës kulturore e artistike, për evidencimin e vlerave, përzgjedhjen e talenteve etj. Për probleme të veçanta me karakter profesional ai ka të drejtë vendimore.

Këshillat janë të rinovueshme.

2. Anëtarët e organizmave këshillimore të kulturës, për ndihmesën që japin në fushën e artit e të kulturës përfitojnë të drejtën e shpërblimit.

3. Përfitojnë të drejtën e shpërblimit edhe personat që aktivizohen në këshilla të përkohshëm kuklturorë e artisitikë, si juri, komisione shkencore, të vlerësimit etj.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve dhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të nxjerrin udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi dhe të përcaktojnë masën e shpërblimit.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.467, datë 24.12.1991 "Për krijimin e këshillave të kulturës", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi